



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



362/22
21.10.22

PRISHTINË - PRISTINA

PSH.nr 362/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Nita Bejta- Kryetare, Vedat Poterqoi – Anetar, Vjosa Gradinaj- Mexhuani – Anetare, Agon Ramadani – Anetar dhe Kimete Gashi- Anetare duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE ankues “Security Code” shpk - Prishtine, kundër njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik për Objekte Shendetsore publike (QKMF dhe QMU)”, me nr. të prokurimit: 616-20-1945-211, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine, më datën: 20.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Security Code” shpk - Prishtine, kundër njoftimit mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit AK-së, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Sigurimi fizik për Objekte Shendetsore publike (QKMF dhe QMU)”, me nr. të prokurimit: 616-20-1945-211, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Kuvendi Komunal Prishtine.

II. ANULOHET, vendimi i Autoriteti Kontraktues (AK) - Kuvendi Komunal Prishtine për anulimin e aktivitetit të prokurimit “Sigurimi fizik për Objekte Shendetsore publike (QKMF dhe QMU)”, me nr. të prokurimit: 616-20-1945-211 dhe lënda kthehet në Rivlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Security Code” shpk - Prishtine aprovet si e bazuara, i bëhet kthimi i tarifës së ankesave në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës .

VI. OBLIGOHET operatori ekonomik “Security Code” shpk - Prishtine që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues, OE “Security Code” shpk - Prishtine, si palë e pakënaqur më datën: 19.08.2022, ka parashtruar ankesë me numër 362/22, mbi vendimin e AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit ““Sigurimi fizik për Objekte Shëndetsore publike (QKMF dhe QMU)”, me nr. të prokurimit: 616-20-1945-211 duke pretenduar që AK ka vepruar në kundërshtim me nenet 1,7,28,56, dhe 62 të LPP-se.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 22.09.2022, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të rishiqohet duke marre parasysh LPP-ne.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 30 Shtator 2022 me raportin e ekspertizës.

Autoriteti kontraktues nuk ka njoftuar OSHP-ne lidhur me qëndrimin ndaj mendimit të dhënë nga eksperti shqyrtues.

Operatori ekonomik nuk ka njoftuar OSHP-në lidhur me qëndrimin ndaj mendimit të dhënë nga ekspertit shqyrtues.

Seanca e shqyrtimit të lëndës është mbajtur me datën: 20 Tetor 2022, pa praninë e palëve konform nenit 24.2 të Rregullores së OSHP-se, pasi që nga provat dhe faktet e lëndës paneli shqyrtues ka vlerësuar se ka argumente të mjaftueshme që vendimi të merret edhe pa prezencën e palëve në seancën për shqyrtim kryesor.

Paneli shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde si dhe faktet dhe rrethanat e cituara si më sipër dhe veprimet e ndërmarra nga të dyja palët (OE dhe AK), duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë shkresave të lëndës, në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, PSH sqaron:

Marrë parasysh pretendimet e parashtruara, PSH konstaton se nuk plotësohet asnjë nga kushtet për anulim të tenderit sipas nenit 62 të LPP-se ashtu që ankesa e OE ankuese konsiderohet si e bazuar dhe obligohet AK të anuloi vendimin mbi anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim AK.

Paneli shqyrtues, nëse evidenton se zyrtari përgjegjës i prokurimit, ne te ardhmen bene gabime tjera te mëdha, sikur ky, atëherë me një shkresë do t'i drejtohet KRPP-se dhe do te kërkoj te veproj konform nenit 25 të LPP-se.

Vendimi lidhur me kthimin e tarifës u dha ne kuptim te nenit 31 paragrafi 6 i Rregullores se punës se OSHP-se.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi

Kryetare e Panelit Shqyrtues

zgj. Nita Bejta



Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK– Komuna e Prishtines
- 1x1 OE ankuese
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.